



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

UDHËZIM
Nr. 03 , datë 25.11.2013

“PËR HETIMIN E VEPRAVE PENALE KU I MITURI PËRFSHIHET SI I PANDEHUR, PERSON NËN HETIM, I DËMTUAR DHE/OSE DËSHMITAR”

Me qëllim, përcaktimin e parimeve themelore për mbrojtjen e të drejtave të të miturit të pandehur, person nën hetim, i dëmtuar dhe/ose dëshmitar i veprës penale, të cilat duhet të respektohen gjatë procedimit penal;

Në **mbështetje**, të nenit 54 dhe 119 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Konventës së OKB mbi të Drejtat e Fëmijës (1989) dhe Protokollit të saj shtesë, Kodit të Procedurës Penale, dhe nenit 8 pika 2 e ligjit nr.8737, datë 12.02.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar,

UDHËZ O J:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Parime të përgjithshme

1. Të miturit, për shkak të papjekurisë, aftësive relative për të ushtruar të drejtat e veta dhe shkaqe të tjera objektive të cilat i bëjnë ata të cënueshëm, gëzojnë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti. Mbrojtja që duhet t’i sigurohet gjatë hetimit, duhet të mbështetet te interesi më i lartë i të miturit dhe nevojat e veçanta të secilit, me qëllim që të drejtat e tyre të përmbushen në mënyrë të barabartë.
2. Për drejtimin dhe ndjekjen e hetimeve të veprës penale ku i mituri përfshihet si i pandehur/person nën hetim caktohen prokurorët e seksioneve të të miturve¹ të cilët kanë përvojën e duhur në hetimin e veprës penale konkrete dhe trajnohen në mënyrë të vazhdueshme për të trajtuar të miturit. Lëvizja e këtyre prokurorëve nga seksioni i të miturve bëhet vetëm me miratim të Prokurorit të Përgjithshëm. Për drejtimin dhe ndjekjen e hetimeve të veprës penale ku i mituri përfshihet si i dëmtuar dhe/ose dëshmitar i veprës penale, caktohet edhe një prokuror i seksionit të të miturve.
3. Prokurori duhet të hetojë me përparësi veprat penale ndaj të miturve.

¹ Në përputhje me urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm nr.163 datë 01.10.2007 “Për krijimin dhe caktimin e strukturës organike, funksionimin dhe kompetencat e seksioneve për të mitur në prokuroritë e rretheve gjyqësore”.

4. Prokurori duhet të marrë të gjitha masat që të shmangët çdo vonesë gjatë hetimeve paraprake dhe përse është e mundur edhe gjatë procesit gjyqësor, ku i mituri përfshihet si i pandehur, person nën hetim, i dëmtuar dhe/ose dëshmitar i veprës penale.

Neni 2

Interesi më i lartë i të miturit

Prokurori dhe oficeri i policisë gjyqësore, gjatë hetimit dhe gjykimit të veprës penale, ku përfshihet një i mitur si i pandehur, person nën hetim, i dëmtuar dhe/ose dëshmitar, duhet të udhëhiqet nga parimi i interesit më të lartë të të miturit, duke e konsideruar atë si parësor ndaj interesave të tjerë në të gjitha veprimet, vendimet dhe çështje me subjekte të mitur.

Neni 3

E drejta për të mos iu nënshtruar torturës

1. Prokurori dhe oficeri i policisë gjyqësore, duhet të sigurojnë që i mituri të trajtohet në mënyrë të tillë që të nxitë tek ai ndjenjën e dinjitetit dhe vlerës për veten.
2. Prokurori dhe oficeri i policisë gjyqësore duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë respektimit të së drejtës së të miturit për të mos iu nënshtruar asnjë forme keqtrajtimi apo sjelljeje fyese e denigruese që përfshijnë fjalorin e rëndë dhe të ashpër të përdorur ndaj tij, dhunën morale, psikologjike apo fizike me veprime apo mosveprime.
3. Në rast të konstatimit të një shkelje të tillë, duhet të merren masat e nevojshme për rivendosjen e kësaj të drejte, për aq sa është e mundur, si dhe për procedimin e personave përgjegjës.

Neni 4

Ndihma psikologjike dhe ndihma mjekësore

1. Prokurori dhe oficeri i policisë gjyqësore duhet të kërkojë asistencë, të këshillohet në mënyrë të vazhdueshme, dhe të sigurojë që gjatë çdo veprimi hetimor (marrja në pyetje, kqyrja, njohja, ballafaqimi) të jenë të pranishëm, specialistë psikolog, punonjës social, specialist me përgatitje të posaçme, për të trajtuar çështje si ajo objekt hetimi, apo prindi/kujdestari/çdo person i tretë mbi 18 vjeç, i kërkuar nga i mituri dhe i pranuar nga autoriteti që procedon.
2. Prokurori duhet të marrë masa që në çdo fazë të procedimit të miturit t'i ofrohet kujdesi i nevojshëm mjekësor duke patur parasysh gjendjen shëndetësore të tij dhe kërkesat e paraqitura nga ai, avokati apo familjarët e tij.
3. Në përzgjedhjen e specialistëve të përmendur në pikat 1 e 2 të këtij neni, duhet të mbahen parasysh kriteret e mëposhtme:
 - a) të jenë të të njëjtës gjini me të miturin;
 - b) të jenë të trajnuar në punën me të miturit;
 - c) të kenë aftësi të larta komunikuese me ta.

Neni 5

Trajtimi me dinjitet dhe dhembshuri

1. Gjatë hetimeve paraprake, të sigurohet respektimi i dinjitetit dhe i të drejtës për t'u trajtuar me dhembshuri, i të miturit të përfshirë në një procedim penal, duke u trajtuar në mënyrë të kujdesshme, të ndjeshme dhe të përshtatshme, në përputhje me moshën, pjekurinë

intelektuale, aftësinë për të ushtruar të drejtat e veta, si dhe në respektim të integritetit të tij fizik, mendor dhe moral.

2. Në caktimin e prokurorit që do të trajtojë një çështje penale ku përfshihen të mitur, Drejtuesi i Prokurorisë duhet të sigurojë që marrja në pyetje e të miturit të bëhet për aq sa është e mundur nga prokurorë dhe oficerë të Policisë Gjyqësore të së njëjtës gjini.

Neni 6

Mosdiskriminimi

Prokurori dhe oficeri i policisë gjyqësore duhet të mos shfaqin vet personalisht, të luftojnë dhe të mos lejojnë sjelljet diskriminuese lidhur me përkatësinë etnike ose kombësinë, përkatësinë shoqërore, pasurinë, paaftësinë, moshën, aftësinë e kufizuar, seksin, besimet fetare, pikëpamjet politike, orientimin seksual, prejardhjen familjare apo çdo gjendje tjetër të fëmijës ose prindërve të tij ose përfaqësuesve të tij ligjorë apo çdo konsideratë tjetër, të ndikojnë në trajtimin e të miturit ose në marrjen e vendimeve gjatë procedimit penal ku ata përfshihen.

Neni 7

E drejta për t'u dëgjuar

Prokurori dhe oficeri i policisë gjyqësore duhet të garantojnë të drejtën e të miturit për t'u dëgjuar në çdo kohë dhe t'a informojnë atë mbi të drejtën për të mos dëshmuar kundër vetvetes.

Neni 8

E drejta e respektimit të jetës private

1. Prokurori dhe oficeri i policisë gjyqësore duhet të garantojnë respektimin e të drejtës së të miturit për mbrojtjen e jetës së tij private gjatë gjithë fazave të procedimit, deri në vendimin përfundimtar.
2. Kur media shkel të drejtën e të miturit përse i përket jetës private dhe fshehtësisë së informacionit, prokurori, kur janë kushtet ligjore, fillon ndjekjen penale.

Neni 9

Fshehtësia e informacionit dhe ndalimi i publikimit

1. Prokurorët kanë detyrim të respektojnë dhe të marrin masa për mbrojtjen e fshehtësisë së informacionit dhe publikimin e akteve, për të miturin të pandehur, person nën hetim, i dëmtuar dhe/ose dëshmitar të veprës penale, veçanërisht ato që mund të çojnë në identifikimin e të miturit si autor të veprës penale. Duhet të shmangët publikimi i emrave, identikitit, të dhëna që mundësojnë identifikimin e familjes së të miturit, komentimi i ngjarjes në të cilën i mituri është përfshirë apo motiveve dhe qëllimeve që ka kërkuar të arrijë me veprën penale dhe çdo mundësi që të tretët ta evidentojnë atë si autor i veprës penale.
2. I gjithë dokumentacioni që përmban të dhëna për identitetin e të miturit ose të dhëna të tjera rreth tij, duhet të mbahet në një vend të sigurt ku nuk ka akses asnjë person tjetër dhe u bëhet i ditur vetëm atyre personave që për shkak të përfshirjes së tyre në procedim kanë arsye që ta marrin këtë informacion.

3. Kur shkelja e ndalimit të publikimit është bërë nga nëpunësi shtetëror ose i një enti publik, dhe nuk përbën vepër penale, prokurori njofton organin epror për marrjen e masave disiplinore.

KREU II

RREGULLA PËR PROCESIN PENAL KU I MITURI PËRFSHIHET SI I PANDEHUR/PERSON NËN HETIM

Neni 10

E drejta për t'u informuar

Prokurori dhe oficeri i policisë gjyqësore duhet të marrin masa, duke respektuar me rigorozitet dispozitat procedurale penale, për të informuar të miturin menjëherë dhe drejtëpërdrejtë dhe/ose nëpërmjet prindit/përfaqësuesit të tij ligjor mbi akuzat e ngritura kundër tij, të drejtën për të përfituar ndihmë juridike falas si dhe çdo ndihmë tjetër të nevojshme për mbrojtjen e tij.

Neni 11

Njoftimi i akuzës të pandehurit të mitur

1. Prokurori dhe oficeri i policisë gjyqësore duhet të marrin masa për t'i njoftuar akuzën të miturit, menjëherë dhe drejtëpërdrejtë dhe/ose nëpërmjet prindit/përfaqësuesit të tij ligjor, nëpërmjet dorëzimit të aktit të njoftimit të akuzës.
2. Prokurori dhe oficeri i policisë gjyqësore duhet të marrin masa që akti i njoftimit të akuzës të përmbajë të dhënat e mjaftueshme për marrjen e të miturit në cilësinë e të pandehurit dhe të sigurohen se i mituri e ka kuptuar akuzën që është ngritur kundër tij duke iu përgjigjur pyetjeve që ai mund t'u drejtojë.

Neni 12

Marrëdhëniet me prindërit e të miturit, përfaqësues të shkollës apo qendrës së tij të banimit

1. Prokurori dhe oficeri i policisë gjyqësore duhet të krijojnë dhe mbajnë marrëdhënie të hapura dhe bashkëpunuese me prindërit e të miturit dhe/ose me përfaqësuesin e tij ligjor.
2. Prokurori dhe oficeri i policisë gjyqësore duhet të garantojnë pjesëmarrjen në hetim të prindërve, përfaqësuesit ligjor apo personave të besuar të të miturit, pasi kjo është në interesin më të lartë të të miturit, përveç rasteve kur pjesëmarrja e tyre vlerësohet se dëmton interesat e të miturit.
3. Prokurori dhe oficeri i policisë gjyqësore duhet të marrin masa që pavarësisht nevojave të hetimit, i mituri të mos shkëpusë marrëdhëniet me ambientin e tij familjar dhe edukativ, të ruajë kontaktet me institucionet arsimore apo entitete të tjera të cilat kanë efekt edukativ tek ai.

Neni 13

E drejta për mbrojtje efektive

1. Prokurori dhe oficeri i policisë gjyqësore informojnë menjëherë të miturin që ka të drejtë të ndihmohet nga një avokat i zgjedhur prej tij apo familja e tij dhe nëse ai apo familjarët nuk kanë mundësi të zgjedhin një avokat, përfiton mbrojtjen nga një avokat i caktuar kryesisht.

Për të garantuar një mbrojtje sa më efektive dhe të plotë, brenda kufijve që u lejon ligji, prokurori dhe oficeri i policisë gjyqësore informon të miturin dhe familjarët e tij duke u vënë në dispozicion listën e avokatëve kryesisht.

2. Prokurori dhe oficeri i policisë gjyqësore, në prani të avokatit apo të familjareve të tij, i shpjegojnë të pandehurit të mitur faktin që i atribuohet, provat që ekzistojnë kundër tij, të drejtën e aksesit në provat e mbledhura dhe kur nuk dëmtohet hetimi edhe burimin e tyre.

Neni 14

Marrja në pyetje

1. Prokurori dhe oficeri i policisë gjyqësore duhet të bëjnë të gjitha përgatitjet paraprake duke u kujdesur që marrja në pyetje t'i shërbejë jo vetëm zhvillimit të paanshëm të hetimeve paraprake, por të realizojë konkretisht të drejtat dhe interesat e të miturit.
2. Prokurori dhe oficeri i policisë gjyqësore para se të fillojnë pyetjen i shpjegojnë të pandehurit të mitur, prindit të tij dhe/ose dhe përfaqësuesit të tij ligjor, të drejtën për të mos u përgjigjur dhe se edhe po të mos përgjigjet procedimi do të vazhdojë. Marrja në pyetje vijon vetëm pas daklarimit nga përfaqësuesi ligjor se kjo e drejtë është kuptuar dhe i mituri heq dorë prej saj.
3. Prokurori dhe oficeri i policisë gjyqësore duhet t'i bëjë të ditur të miturit se çdo e dhënë do të mbahet në mënyrë konfidenciale dhe do të përdoret vetëm për qëllime të këtij procedimi penal.
4. Veprimet e mësipërme përshkruhen në procesverbal.
5. Prokurori dhe oficeri i policisë gjyqësore, duhet të sigurojnë marrjen në pyetje të të miturit në një ambient miqësor, duke krijuar kushte të përshtatshme në përputhje me gjininë, gjendjen e tij shëndetësore dhe psikologjike. Marrja në pyetje duhet të zhvillohet pa ndërprerje apo ndërhyrje të personave të paautorizuar, përveç rasteve kur ndërprerja diktohet nga gjendja shëndetësore, psikologjike apo mungesa e përqëndrimit nga i mituri.
6. Gjatë marrjes në pyetje, toni dhe mënyra e komunikimit të pyetjeve duhet të jetë e përshtatshme për të miturin dhe në asnjë rast të mos jetë i tillë që tregon agresivitet, ashpërsi dhe kërcënim. Rregulla të hollësishme për procesin e marrjes në pyetje të të pandehurit të mitur, janë parashikuar në Ankesin 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Neni 15

Caktimi i masave të sigurimit

1. Prokurori në kërkimin e tij për vendosjen e masave të sigurimit ndaj të pandehurit të mitur, duhet të mbajë parasysh nevojën për mosndërprerjen e proceseve të tij edukative.
2. Masa e sigurimit "arrest në burg" mund të kërkohet vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme, vlerësuar kjo në mënyrë të kujdesshme në përputhje me rëndësinë e veprës, personalitetin e të miturit, qëndrimin e tij ndaj veprës, rrethanat lehtësuese e rënduese.

Neni 16

Kontrolli i veprimtarisë policore

Prokurori duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë kontrollit të ligjshmërisë dhe profesionalizmit të akteve hetimore të mbledhura nga policia gjyqësore, në mënyrë të posaçme atyre që lidhen me njoftimin e menjëhershëm të prindërve ose përfaqësuesve të tij ligjor të cilët duhet të jenë të pranishëm në të gjitha procedurat, dhe të vlerësojë çdo ankesë

të paraqitur nga i mituri, mbrojtësi apo përfaqësuesi i tij ligjor, në lidhje me veprimtarinë e organeve policore.

Neni 17

Roli i prokurorit gjatë shqyrtimit gjyqësor

1. Gjatë shqyrtimit gjyqësor, prokurori nuk duhet të komentojë apo veprojë në mënyrë të tillë që të paragjykohet se vendimarrja e gjykatës është në favor apo disfavor të tij.
2. Prokurori duhet të jetë proporcional në kërkimet për caktimin e dënimit, duke ruajtur raportin e rëndësisë së shkeljes, të drejtës së të dëmtuarit, nevojës për trajtim të posaçëm të të miturit dhe dënimit që kërkohet të caktohet ndaj tij.
3. Prokurori, në parim, duhet të mbështesë qëndrimin se dënimi me burgim i të miturit, duhet aplikuar si masë e fundit që jepet vetëm për kryerjen e krimeve të rënda dhe për një afat kohe të shkurtër dënimi.
4. Prokurori, duke mbajtur në konsideratë se qëllimi i politikës penale për të miturit është rehabilitimi dhe integrimi i tyre në shoqëri, duhet të kërkojë dhe të mbështesë aplikimin e neneve 52 e 53 të Kodit Penal si dhe caktimin e dënimeve alternative të parashikuara në Kodin Penal, duke i konsideruar ato si masat më të përshtatshme në interes të të miturit, që nxisin dhe krijojnë mundësinë e ruajtjes së kontakteve të të miturit me familjen, shkollën, punën e shoqërinë.

Neni 18

Masa gjatë vuajtjes së dënimit

1. Prokurori duhet të konsiderojë me kujdes të veçantë çdo informacion apo ankesë në lidhje me mënyrën e ekzekutimit të dënimit me burgim për të dënuarin e mitur duke marrë masa për të gjitha të drejtat e garantuara nga ligji, përfshirë veçimin nga të rriturit, trajtimin me dinjitet dhe ndalimin e dhunës apo torturës.
2. Përsa është e mundur prokurori duhet të marrë masa që i mituri të vendoset në institucione të dënimit që janë afër vendit ku ai banon, për të garantuar të drejtën e të miturit të dënuar me burgim për të mbajtur lidhjet e kontaktet me familjen e tij.
3. Prokurori i caktuar me ekzekutimin e vendimeve penale, duhet të ketë parasysh në përzgjedhjen e institucionit të vuajtjes së dënimit për të miturin, se të miturit duhet t'i sigurohet procesi edukativ sipas një programi arsimor, edukativ e kulturor të përshtatshëm për të.

KREU III

RREGULLA PËR PROCESIN PENAL KU I MITURI PËRFSHIHET SI I DËMTUAR DHE/OSE DËSHMITAR

Neni 19

E drejta për t'u informuar

1. Prokurori dhe oficeri i policisë gjyqësore duhet t'i ofrojë të miturit të dëmtuar dhe/ose dëshmitar apo përfaqësuesit të tij ligjor, informacionin përkatës për asistencën ligjore dhe psikologjike falas, shërbime mjekësore, mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës, ecurinë e çështjes, të drejtën për të kërkuar dëmshpërblim për veprën penale të kryer ndaj tij, statusin e të pandehurit, planifikimin e seancave dëgjimore dhe vendimet që jepen, në mënyrë që të jetë e përshtatshme për fëmijën, moshën, gjuhën dhe kapacitetin e tij për të kuptuar.

2. Prokurori dhe oficeri i policisë gjyqësore duhet të informojnë të miturin se nuk ka për detyrë të dëshmojë për të dhëna dhe fakte mbi ngjarjen nga të cilat lind përgjegjësia për të.
3. Prokurori dhe oficeri i policisë gjyqësore duhet të informojnë të miturin dëshmitar në moshën 14-18 vjeç, se ai ka detyrimin për të dëshmuar përpara gjykatës dhe për t'ju përgjigjur me vërtetësi pyetjeve.
4. Veprimet e mësipërme përshkruhen në procesverbal.

Neni 20

Marrja e të dhënave të miturit të dëmtuar/dëshmitar të veprës penale

1. Prokurori dhe oficeri i policisë gjyqësore, marrin të dhëna nga i mituri i dëmtuar ose që ka mund të tregojë rrethana të dobishme për qëllime të hetimit, duke siguruar paraprakisht kushtet e nevojshme që i mituri të shpreh lirisht dhe në mënyrën e tij, pikëpamjet dhe shqetësimet lidhur me procesin penal, sigurinë lidhur me të akuzuarin dhe ndjenjat e tij për përfundimin e procesit. Këto kushte përfshijnë pa u kufizuar:
 - a) Marrjen e deklarimeve/pyetjeve me praninë e prindit ose kujdestarit ligjor, një personi mbështetës të zgjedhur nga i mituri, si dhe të një specialisti;
 - b) Marrjen e deklarimeve/pyetjeve të miturit në një mjedis të përshtatshëm për të, si shkolla, shtëpia apo një qendër për mbështetjen e të miturve;
 - c) Marrjen e masave në mënyrë që të kufizohet sa më shumë numri i marrjes në pyetje duke regjistruar deklaratimet me shkrim, audio ose video;
 - d) Të kërkohet nga gjykata marrja e dëshmisë së të miturit me mjete audiovizuale;
2. Prokurori ose oficeri i policisë gjyqësore marrin konfirmimin nga eksperti psikolog, që i mituri i dëmtuar/dëshmitar i një veprë penale ka aftësinë fizike, mendore apo emocionale për të deklaruar në një kohë të caktuar apo në përgjithësi.
3. Prokurori ose oficeri i policisë gjyqësore gjatë marrjes së deklarimeve nga i mituri duhet të sigurojnë asistencën e një personi mbështetës, por nuk duhet të lejojnë që këta persona t'i përgjigjen pyetjeve që i bëhen të miturit. Në këtë proces duhet të merret parasysh çdo kërkesë e të miturit që të mos jenë të pranishëm persona të tjerë.
4. Të miturit të dëmtuar/dëshmitar të veprës penale i shpjegohet qëllimi dhe roli i tij në këtë proces. Rregulla të hollësishme për procesin e marrjes së deklarimeve nga të miturit, janë parashikuar në Ankesin 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Neni 21

E drejta për asistencë të efektshme

1. Prokurori dhe oficeri i policisë gjyqësore duhet t'i bëjnë të ditur të miturit të dëmtuar dhe/ose dëshmitar, se gëzon të drejtën të përfitojnë shërbime mbështetëse financiare, ligjore, këshillimore, shëndetësore, sociale, arsimore apo shërbimeve të tjera të nevojshme për ri-integrimin e të miturve.
2. Prokurori duhet të monitorojë mundësinë që kanë të miturit për të përdorur shërbimet mbështetëse të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Prokurori duhet të kërkojë caktimin e një kujdestari për fëmijën ose zbatimin e masave të tjera të asistencës, kur është rasti.

Neni 22

Mbrojtja nga vështirësitë e procesit penal

1. I mituri i dëmtuar dhe/ose dëshmitar i veprës penale duhet të sigurohet se do të jetë i mbrojtur nga organet shtetërore në lidhje me pasojat që mund të ketë nga roli i tij në këtë procedim.

2. Prokurori duhet të marrë masa që seancat e deklarimeve të mos jenë të tejzgjatura dhe të përsëritura.
3. Prokurori duhet të njoh dhe familjarizojë të miturin me procedurën gjyqësore, përpara daljes në gjyq.

Neni 23 **Sigurimi i provës**

1. Gjatë hetimeve në procedimet penale ku të miturit përfshihen si viktimat dhe/ose dëshmitarë, të vlerësohet rast pas rasti nevoja për të kërkuar në gjykatë “sigurimin e provës”, në mënyrë që të shmangët përsëritja e veprimeve hetimore si marrja e deklarimeve/dëshmisë së të miturit, veprimet e njohjes, ekspertimet ose veprime të tjera hetimore, dhe të sigurohet provueshmëria e akuzës.
2. Kur është e mundur, prokurori, duhet të kërkojë nga gjykata që në seancën e sigurimit të provës, i mituri të pyetet në distancë me anë të lidhjes audiovizive.

Neni 24 **E drejta për siguri**


1. Në rastet kur i mituri i dëmtuar dhe/ose dëshmitar i veprës penale është objekt kanosje, kërcënimi ose dëmtimi, prokurori menjëherë pasi vihet në dijeni merr masat e mëposhtme:
 - a) Fillon procedimin penal ndaj personit përgjegjës, kur është rasti;
 - b) Kërkon nga gjykata sipas rastit caktimin/ndryshimin e masës së sigurimit “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi”, për personin përgjegjës;
 - c) Kur është e nevojshme i jepet të miturit mbrojtje nga policia e shtetit, përsa kohë vlerësohet e nevojshme;
 - d) Merr masa për të shmangur kontaktin mes të miturit dhe autorëve të veprës penale gjatë hetimeve paraprake, dhe kërkon nga gjykata të veprojë në të njëjtën mënyrë edhe gjatë procesit gjyqësor.

Neni 25 **Dispozita zbatuese**

1. Të njihen me këtë udhëzim oficerët e policisë gjyqësore, prokurorët dhe drejtuesit e Prokurorive të të gjithë niveleve.
2. Për të ndjekur dhe kontrolluar zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen prokurorët dhe drejtuesit e Prokurorive të të gjitha niveleve.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

PROKURORI I PËRGJITHSHËM
ADRIATIK LLALLA



ANEKSI 1

Informacion mbi teknikat miqësore të intervistimit të të miturve viktima, dëshmitarë dhe të dyshuar².

Hyrje

Qëllimi i këtij protokoll është të ndihmojë oficerët e policisë gjyqësore të kryejnë një intervistim të sukseshëm me fëmijët të cilët janë të përfshirë në një proces ligjor në pozitën e dëshmitarit, i dëmtuar apo të dyshuarit të një veprë penale. Nëpërmjet këtij materiali, oficeret e policisë do të njihen me informacionin dhe teknikat e duhura për të grumbulluar një informacion sa më të vlefshëm për procesin e hetimit, si dhe për të motivuar të intervistuarin të rrëfejë nëse është i përfshirë në vepra penale. Informacioni në vijim shtjellon procesin e intervistës hetimore me të miturit. Kjo formë intervistimi synon të grumbullojë informacion dhe prova dhe është e përshtatshme si në rastet kur i mituri është i dëmtuar apo dëshmitar ashtu edhe kur është në pozitën e të dyshuarit. Protokollin përbëhet nga katër pjesë.

1. Përgatitja për intervistë
2. Procesi i intervistimit
3. Elementë të rëndësishëm të procesit të intervistimit
4. Elemente të vecantë të zhvillimit të fëmijëve adoleshent që ndikojnë mbi dinamikën e intervistës.

I. Përgatitja për intervistë

1. Planifikimi dhe përgatitja për intervistë

Qëllimi i një interviste hetuese është të marrë rrëfimin e dëshmitarit mbi ngjarjen e ndodhur dhe cdo lloj informacioni tjetër që mund të jetë me rëndësi për çështjen. Një intervistë mund të arrihet mirë vetëm nëse bëhet një planifikim i mirë i saj. Shpesh herë sukseset e gjithë procesit të hetimit varet nga një intervistë e mirë. Për këtë arsye, një planifikim i mirë i cili do të konsiderojë cdo informacion të mundshëm mbi të intervistuarin si dhe do të vendosi objektivat dhe çështjet kryesore për t'u trajtuar, është i domosdoshëm. Vëmendje të veçantë në këtë proces duhet t'i kushtohet moshës, gjinisë, besimit fetar, etnisë (në rastet e komunitetit rom dhe egjiptian) dhe aftësinë për t'u shprehur.

Gjatë fazës së planifikimit do të ishte e udhës që të diskutohet me të intervistuarin nëse do të preferonte që seanca e intervistimit të regjistrohej me anë të video regjistruarit apo me shënime.

Planifikimi i intervistës përfshin marrjen e informacionit në tre fushat në vijim;

- Informacion mbi fëmijën dëshmitar
- Informacion mbi ngjarjen e dyshuar
- Informacion i rëndësishëm për hetimin

Edhe pse shpesh herë rrethanat nuk e lejojnë intervistuesin që të ketë informacion të detajuar mbi të intervistuarin, ai duhet të grumbullojë sa më shumë informacion në lidhje me pikat e mëposhtme;

- Moshë
- Adresa
- Orientimi seksual (kjo mund të jetë e rëndësishme nëse vepra e ndodhur ka elementë të sjelljes seksuale)
- Probleme të mundshme të shëndetit fizik apo atij mendor
- Rrethanat familjare (nëse personi i intervistuar jeton në një mjedis të sigurtë familjar)

² YUILLE J., The Step Wise Interview, A protocol for interviewing children

- Marrëdhënia e dëshmitarit me autorin e dyshuar (nëse ka arsye të besohet një lidhje e tillë)
- Nëse personi i intervistuar kurohet me ilace të cilat mund të kenë efekt gjatë procesit të intervistimit
- Gjëndja emocionale aktuale, (duke përfshirë tronditje psikologjike për shkat të eksperiencave traumatike, frike, depresion, apo stress për shkak të ngjarjeve të përjetuara së fundmi.
- Efekti i mundshëm i eksperiencave traumatike në kujtesën e dëshmitarit.
- Kontaktet e mëparshme me shërbimet publike si spitalet apo komisariatet e policisë.

Informacion rreth veprës së dyshuar

Do të ishte e këshillueshme që për qëllim të intervistës, intervistuesi të kishte detaje mbi veprën e dyshuar. Për të planifikuar një intervistë të sukseshme intervistuesi duhet të ketë informacion rreth pikave në vijim;

- Lloji i veprës së kryer
- Koha e përafërt e ndodhjes së ngjarjes dhe vëndi
- Skena e veprës së dyshuar (informacion i përgjithshëm që do të ndihmontë intervistuesin të kuptojë se çfarë do të thuhet gjatë intervistës.)
- Cdo lloj frike të të intervistuarit për të mos bashkëpunuar

2. Planifikimi i informacionit

Planifikimi i informacionit është një element shumë i rëndësishëm i procesit të intervistimit. Ai shërben për të vendosur;

- Qëllimin dhe objektivat e intervistës
- Teknikave që duhen përdorur gjatë intervistës
- Mënyrën se si do të regjistrohet intervista
- Vëndin dhe kohën e intervistës
- Kohëzgjatjen e intervistës (duke përfshirë dhe pushimet)
- Çfarë mund të ndodhë pas intervistës

3. Përgatitja e fëmijës për intervistë

Fëmija duhet të përgatitet gjithmonë për intervistën. Në disa raste përgatitja mund të jetë e shkurtër dhe të kryhet pak castë para intervistimit, ndërsa në raste të tjera ajo mund të kërkojë një shpjegim të detajuar dhe të kryhet disa ora apo dhe ditë përpara intervistës. Përgatitja e dëshmitarit për intervistë konsiston në një shpjegim nga ana e intervistuesit mbi qëllimin e intervistës, arsyen pse ajo regjistrohet, rolin e intervistuesit dhe e cdo personi tjetër që mund të jetë present, vëndin se ku do të kryhet dhe sa kohë mund të zgjasë. Intervistuesi duhet të shpjegojë gjithashtu edhe strukturën e intervistës dhe rregullat bazë të saj. Pyetjet apo shqetësimet e dëshmitarit në lidhje me procesin (intervistia të tjera të mundshme, dëshmi në Gjykatë etj) duhet të sqarohen gjatë kësaj faze.

Dëshmitarët të cilët janë të frikësuar apo jo të motivuar për të kryer intervistën, mund të marrin më shumë kohë për t'u njohur me intervistuesin dhe rregullat e intervistës. Në këto raste intervistuesi duhet të vlerësojë nëse ka nevojë për më shumë se një takim me dëshmitarin përpara se ky I fundit të marrë pjesë në intervistë. Gjatë këtij procesi intervistuesi duhet të mbajë shënime të plota.

4. Vëndi i intervistimit

Intervista duhet të kryhet në një dhomë të krijuar posacërisht për këtë proces. Dhoma duhet të jetë konfidenciale, ku persona të tjerë të cilët nuk janë të përfshirë në intervistë nuk duhet të kenë mundësinë të dëgjojnë nga dritaret apo nga kati i mësipërm. Në dhomë duhet të ketë

karrige të rehatshme, të ketë pranë tualet dhe ujë për të pirë. Të ketë gjithashtu letra dhe mjete për të shkruar. Gjatë intervistës nuk duhet të ketë ndërprerje dhe hyrje-dalje të personave të tjerë. Personi I intervistuar duhet të ndjehet plotësisht rehat me vendin ku do të kryhet intervista.

II. Procesi i intervistimit

1. Vendosja e kontaktit individual

Hapi i parë në një proces intervistimi është vendosja e kontaktit midis intervistuesit dhe të intervistuarit. Syno të vendosësh kontakt të drejtë për drejtë me fëmijën. Mundohu të vendosësh pika të përvashkëta me fëmijën duke I treguar atij diçka nga vetja. Mund t'I ndërthurësh komentet personale me pyetjet që lidhen me situatën aktuale ku gjëndet fëmija, ose mund dhe të prezantosh veten pa e lidhur me situatën konkrete. Fëmija që do të intervistohet, duhet të bindet se edhe pse intervistuesi nuk është në pozitën e tij, ai nuk është një njeri I keq. Mund të përdorni fjalë të tipit:

Unë quhem, po ti si quhesh? Mundohu ti përsëritësh këto së bashku me fëmijën.

Un kam një djalë/vajzë të moshës tënde. Atij/asaj i pëlqen shumë të ...

Mua më pëlqen të bëj xhiro me biçikletë, të luaj futboll etj, po ty çfarë të pëlqen?

Është e rëndësishme që intervistuesi t'a motivojë të intervistuarin të përgjigjet në mënyrën më të mirë të mundshme. Kësisoj, ai duhet të krijojë një atmosferë ku i intervistuari të ndjehet mirë dhe i prirur për të rrëfyer informacion që mund ta vëre në siklet apo dhe kompromentojë. Minutat e para të vendosjes së raportit janë të rëndësishme, sidomos me të intervistuar adoleshent. Këto minuta duhet të shërbejnë për të ulur nivelin e ankthit të të intervistuarit dhe t'a bëjnë atë të ndjehet i qetë për të biseduar. Gjatë vendosjes së kontaktit me një të intervistuar adoleshent, intervistuesi duhet të ketë parasysh pikat në vijim;

Mos ngatërro qëllimin e mirë me një marrëdhënie të mirë. Qëllimi i mirë i intervistuesit nuk është i vetmi element i cili përcakton një fillim të mbarë të intervistës. Një adoleshent mund të mos jetë bashkëpunues apo të shfaqet një komunikues i vështirë me gjithë qëllimin e mirë të intervistuesit. Kjo nuk duhet interpretuar që në fillim si mungesë dëshire për të bashkëpunuar.

Mos e interpreto sjelljen e të intervistuarit si një reagim personal. Mos prezumo se adoleshenti nuk po bashkëpunon për shkakun tënd. Ai/ajo mund të ketë vështirësi të flasë më të rriturit, apo mund të ketë frike ndaj situatave me të cilat nuk është përballur më parë. Mungesa e besimit të të intervistuarit mund të jetë rrjedhojë e abuzimeve të mëparshme.

Përdor shprehje të zhargonit të adoleshentëve. Ato mund të jenë fjalë të cilat përdoren për të shprehur gjëndje apo veprime. Shm. E kam parasysh.. mos m'thuj.. etj. Ka individë të cilët kanë mënyrën dhe fjalorin e tyre për të shprehur mendimet dhe përafrimi dhe ndjekja e këtij stili nga ana e intervistuesit mund të kthehet në një mjet të fortë të vendosjes së raportit.

Lejoje adoleshentin të bëjë pyetje në cdo moment që ai ka nevojë në lidhje me rolin e intervistuesit apo çfarë mund të ndodhë në fazat e mëvonshme të hetimit.

Mundohu të ruash raportit përgjatë gjithë procesit të intervistimit. Mbaj parasysh se raporti midis intervistuesit dhe të intervistuarit është një proces i vazhdueshëm. Mund të përmirësohet gjatë rrjedhës së intervistës por mund dhe të përkeqësohet. Një raport i mirë mund të përballojë stresin që mund të krijohet gjatë bisedës, ndersa një raport jo i mirë mund ta përkeqësojë atë.

Mos thuaj gjithçka thjesht për t'u pëlqyer nga adoleshenti për hir të vendosjes së raportit. Të përpiqesh shumë për të vendosur një raport të mirë mund të ketë edhe efekte të padëshirueshme. Nëse i intervistuari e percepton intervistuesin si një person jo të sinqertë, atëherë ai/ajo nuk do të jetë i prirur për të bashkëpunuar. Vendosja e një balance është shumë e rëndësishme. Një intervistues i suksesshëm e kupton kur duhet dhe kur nuk duhet t'i referohet raportit të mirë me të intervistuarin gjatë intervistës.

2. Rregulla bazë të komunikimit

Është e rëndësishme të krijohet një atmosferë positive miqësore, e cila të nxisë besim tek fëmija. Pranimi i emocioneve të fëmijës krijon besim. Fëmija ka nevojë të kuptojë se të gjitha gjëndjet emocionale janë të lejuara gjatë intervistës, duke përfshirë dhe të qarin. Intervistuesi duhet të bëjë fëmijët të kuptojë se ai mund të përballojë një gjëndje të tillë, duke mos e humbur kontrollin e situatës. Kjo krijon siguri tek fëmija, gjë e cila ndihmon komunikimin. Gjithashtu, një qasje jo kritike nga ana e intervistuesit, ndihmon fëmijën të hapet me lehtë. Veçanërisht tek fëmijët më të vegjël, nuk ndihmon t'i kritikosh ata gjatë kohës së intervistës.

Trego që e pranon rrëfimin e fëmijës duke bërë komente pozitive mbi të.

Nda diçka personale me fëmijën, psh, fol për familjen, fëmijët, çfarë të pëlqen të bësh në kohën

pyesi fëmijën mbi emrat e pjesëve të ndryshme të trupit. Kjo sigurisht i jep intervistuesit emrat me të cilat fëmija quan organet e ndryshme të trupit, por mbi të gjitha pyetja “për çfarë shërben kjo?” duke përfshirë dhe organet gjenitale dhe anusin, mund të jetë një mënyrë për të nxitur rrëfimin.

2.4 Tregimi narrativ

Në këtë fazë shumë të rëndësishme të intervistës lejojeni të intervistuarin të rrëfiet lirshëm në mënyrën e vet. Nëse bëhet fjalë për një rast të vetëm abuzimi, intervistuesi duhet t’i drejtohet fëmijës me fjalët:

Do doja të më tregojë me fjalët e tua çfarë ndodhi.. që nga fillimi e deri në fund.

Gjatë kësaj faze, fëmija nuk duhet të ndërpritet edhe sikur ai të tregojë detaje të parëndësishme apo të përsërisë apo kundërshtojë vetveten. Intervistuesi mund të marrë shënim për paqëndrueshmëritë e informacionit dhe t’i sjellë ato në vëmendje të fëmijës gjatë një fazë së pyetjeve specifike, e cila do të prezantohet më poshtë. Gjatë kësaj faze, fëmija duhet të jetë i lirë edhe të pushojë së foluri. Në këtë moment, intervistuesi duhet të tregohet i durueshëm. Nëse fëmija nuk rifillon të flasë, atëherë intervistuesi me zë të qetë duhet të thotë:

Po pastaj çfarë ndodhi...

Intervista duhet të vazhdojë në një atmosferë të qetë, jo gjykuese dhe të ndjekë hapësirën e fëmijës.

Nëse fëmija mërzhitet së foluri apo shqetësohet gjatë çdo fazë të intervistës, konsideroje serjozisht gjëndjen e tij të stresuar dhe shiko nëse fëmija kërkon të pushojë apo të flasë për diçka tjetër. Kur fëmija të ketë rifituar qetësinë, riktheju çështjes e cila provokoi gjëndjen stresante.

2.5 Pyetjet e hapura

Pasi fëmija ka përfunduar së rrëfyeri atë çfarë di mbi ngjarjen, atëherë intervistuesi mund të fillojë të bëjë pyetje të hapura. Qëllimi i kësaj pjese të intervistës është t’i japë mundësinë të intervistuarit të kujtojë më shume detaje mbi ngjarjen. Nëse një pyetje e hapur risjell fakte të reja mbi ngjarjen, intervistuesi duhet të inkurajojë përsëri tregim narrativ të të intervistuarit. Pyetjet e hapura kërkojnë më shumë detaje mbi një informacion të dhënë me parë. Psh Çfarë mban mënd tjetër për atë që pe në kuzhinë? Kur intervistuesi bën pyetje të hapura, është e rëndësishme që ai t’i shpjegojë fëmijës se nëse përgjigjet me “ Jo” apo “ Nuk e di”, nuk është gabim. Gjithashtu është e rëndësishme që pyetjet e hapura të mos kthehen në pyetje udhëheqëse. Një metodë që do të ndihmonte kujtesën gjatë fazës së pyetjeve të hapura, do të ishte vizatimi i një harte nga intervistuesi ku sipër të shkruhej ngjarja me nje emër dhe poshtë saj të shënoheshin pyetjet Kush?, Ku?, Kur?, Çfarë?. Më pas intervistuesi mund të pyesë: *Shm. Më thuaj gjithçka të kujtohet, se çfarë ndodhi atë ditë në park?* Intervistuesi do ta përsërisë këtë pyetje duke vazhduar *Ku ndodhi? .. Kur ndodhi..?* Në këtë mënyrë intervistuesi mund të marrë informacion në mënyrë jo-sugjestionuese në lidhje me detaje, të cilat nuk janë përmendur në fazën e rrëfimit të lirë narrativ. Kjo është një teknikë që përdoret me fëmijët më të vegjël.

2.6 Pyetjet specifike (Opsionale)

Qëllimi i kësaj faze të intervistës është të qartësojë dhe të zgjerojë përgjigjet e mëparshme. Pyetjet specifike bëhen vetëm nëse gjatë intervistës nuk është siguruar informacion i mjaftueshëm për të vlerësuar besueshmërinë e thënieve.

Në këtë fazë shmang pyetjet me shumë zgjedhje. Nëse duhet të bësh pyetje me alternativa, përfshi sa më shumë nga ato. *Psh. Kjo ndodhi të hënën, të martën, të mërkurën apo nuk e mban mend?* Pak më vonë mund të përsërisësh pyetjen duke ndërruar rendin e alternativave.

Mos përfshi në intervistë informacion të cilin e ke siguruar nga një burim tjetër. *Psh Shoku yt Ervini më tha se ju ishit bashkë atë ditë.* Mund të bëhet një përjashtim nëse informacioni do të përdorej për të nxitur kujtesën *Psh A u takove me ndonjë shok atë ditë?*

Nëse ka kundërshti në thëniet e fëmijës adresoi ato në fund të intervistës. Përmendi këto kundërshti me shumë kujdes. *Psh Ti the se u gervishte te krahu, por the se ishe I veshur me xhup. A mund të më tregosh më mirë se çfarë ndodhi?*

2.7 Mbyllja e intervistës

Cilido që të jetë rezultati i intervistës, intervistuesi duhet të falenderojë fëmijën për pjesëmarrjen. Në këtë fazë intervistuesi duhet të pyesë fëmijën nëse ka ndonjë pyetje, dhe nëse është e mundur ai duhet t'i japë përgjigje. Intervistuesi duhet t'i shpjegojë fëmijës se çfarë do të ndodhë në hapat e mëtejshëm të hetimit. Ai nuk duhet të bëjë premtime që nuk mund t'i mbajë.

III. Elementë të rëndësishëm të procesit të intervistimit

1. Pyet në lidhje me çështje të rëndësishme nga pika të ndryshme vështrimi

Shpërndajii pyetjet në më shumë se një seancë. Kjo ndihmon për të sheshuar mungesat e koherencës si dhe ndihmon për të krijuar një kuadër më të plotë të çështjes kur nuk merr një përgjigje të drejtpërdrejtë në lidhje me të. Kjo lloj metode përdoret zakonisht me fëmijë të cilët mund të mos jenë mjaftueshëm të zhvilluar për të dhënë një përgjigje gjithëpërfshirëse që në fillim, apo të kuptojnë qartë se çfarë pritet prej tyre. Një qasje graduale është gjithashtu e përshtatshme sidomos kur çështja në fjalë përbën ngjarje traumatike për fëmijën.

Gjithsesi nëse fëmija e kupton këtë strategji dhe fillon të ndjehet jo rehat apo të frikësohet, sigurohu që ai të mos krijojë përshtypjen se përgjigjia e parë ishte "e gabuar" apo "jo e mjaftueshëm e mirë" apo një gënjeshtër; sepse fëmija do të përpiqet të japë një përgjigje "më të mirë" thjesht për të kënaqur intervistuesin. Nëse mendon se fëmija nuk po tregon të vërtetën përpiqu të kuptosh arsyet në një mënyrë sa më të ndjeshme. Është e rëndësishme që të mbahen hapur kanalet e komunikimit. Nëse është e nevojshme, shpjego funksionin e përsëritjes së pyetjeve duke përqendruar vëmendjen tek ju si intervistues duke thënë psh;

Un nuk e kuptova se çfarë më the për X ngjarje. A mund të ma shpjegosh përsëri.. kush, si, çfarë, kur, ku..

Un e dëgjova se çfarë the ne lidhje me X ngjarje, por kam nevojë të kuptoj më mirë rreth kush, si, çfarë, kur, ku..

2. Intervista kongnitive

Nëse i intervistuari e ka të vështirë të kujtojë detaje mjaftueshëm në lidhje me ngjarjen apo besueshmëria e thënieve është e ulët atëherë disa teknika do të vinin në ndihmë. Teknikat në vijim janë më të përshtatshme për t'u përdorur me fëmijët në moshën e adoleshencës.

- *Rivendosja e kontekstit.* Kërkoji të intervistuarit të krijojë në mënyrë imagjinare rrethanat në të cilat ka ndodhur ngjarja (çfarë po bënte para ngjarjes, me kë ishte, si ishte veshur etj..)
- *Rikujtimi i plotë.* Kërkoji të intervistuarit të kujtojë gjithcka edhe pse mund të duken gjëra të parëndësishme.
- *Këndvështrim I ri.* Kërkoji të intervistuarit të rikujtojë ngjarjen nga një këndvështrim tjetër.
- *Rikujtimi mbrapsh.* Kërkoji fëmijës t'a rikujtojë ngjarjen nga detajet e fundit tek ato të fillimit.

3. Gjinia e intervistuesit

Fëmijët të cilët kanë qënë viktime të abuzimi seksual mund të ndjehen me rehat nëse flasin me një intervistues të të njëjtës gjini. Është mirë që gjinia e intervistuesit të sqarohet që në fillim të intervistës.

4. Mbajtja e shënimeve

Me fëmijët e vegjël është e këshillueshme të mos mbahen shënime gjatë intervistimit. Intervista mund të regjistrohet dhe të zbardhet më vonë. Të shkruarit mund të frenojë fëmijën për të foluar, sepse kjo mund të interpretohet nga ky i fundit se shqetëson punën e intervistuesit të rritur. Disa fëmijë mund të jenë dhe shumë dyshues rreth asaj që shkruhet dhe mund të përjetojnë ankth gjatë intervistimit edhe pse nuk e shprehin atë me fjalë. Gjithsesi nëse vendos të mbash shënime gjatë intervistës, është e këshillueshme që ta pyesësh fëmijën nëse e kupton pse po mban shënime dhe cili është funksioni i këtij veprimi. Psh:

Siç biseduam sot, unë do të shkruaj (në letër apo kompjuter) atë çfarë ne biseduam, sepse është e rëndësishme. Mos u shqetëso nga kjo gjë. Nëse unë më vonë harroj atë çfarë biseduam, mund ta shoh te shënimet. Kur historia që ti tregove shkruhet, ne nuk kemi nevojë të pyesim përsëri rreth saj. Këto shënime me ndihmojnë mua të kuptoj më mirë se çfarë të ka ndodhur dhe të vendos se çfarë do ishtë me e mira për ty.

Fëmijëve më të mëdhej që mund të lexojnë dhe shkruajnë mund t'u thuash:

Me vonë dikush do të lexojë për ty atë që është shkruar, kështu që nese mendon se ka ndonjë gjë të pavertetë apo të pasakë mund ta korrigjosh.

5. Komunikimi verbal

Përpiqu të zhvillosh një komunikim jo formal. Më mirë se të zhvillosh një proces intervistimi vetëm me pyetje dhe përgjigje nga fillimi në fund, përpiqu të zhvillosh një komunikim të hapur. Në fillim lëre fëmijën të tregojë historinë me fjalët e veta dhe më pas përpiqu të mbushësh boshllëqet e mundshme me anë të pyetjeve. Përpiqu të mos e bësh intervistën me pyetje të shkëputura nga njëra tjetra. Komunikimi bëhet më i thjeshtë kur bëhen edhe komente të përshtatshme duke treguar se e pranon versionin e fëmijës ashtu siç e tregon. Përpiqu të ruash një atmosferë informale gjatë gjithë intervistës, sidomos me fëmijët më të vegjël.

Shpjego se nuk ka problem nëse fëmija nuk preferon t'i përgjigjet një pyetje të caktuar. Kjo enxit fëmijën të mos përpiqet të gënjejë, gjë e cila ul nivelin e ankthit dhe ndihmon kujtesën të funksionojë më mirë, duke krijuar kështu një atmosferë pozitive komunikimi.

5.1 Si të formulosh një pyetje

Përdor pyetje të hapura për të nxitur përgjigje narrative:

- *Ti më the se atë ditë ti ishe te shtëpia e gjyshës. Më trego çfarë bëre atë ditë..*

Përcakto qartë pyetjet që lidhen me detaje;

Më trego sa më mirë që mundesh;

- *Çfarë të tha në fillim?*
- *Kush erdhi tek dera më pas?*
- *Kush e mori vesh që.. ?*
- *Ku ndodhet dhoma?*
- *Kur ta tha mamaja këtë gjë?*

Bëji pyetjet me rradhë. Mos vendos më shumë se një pyetje në një fjali.

Me një fëmijë të vogël bëj pyetje mbi gjëra konkrete dhe të vëzhdueshme, jo mbi gjëra abstrakte apo hipotetike. Kërkoji fëmijës të thotë me fjalët e tij se çfarë kupton ai me një term të caktuar që përdor. Përdor fjali të shkurttra dhe fjali të thjeshta. Mundohu të shmangësh përdorimin e shumë pyetjeve të mbyllura (pyetje që kërkojnë përgjigje me një fjalë apo frazë të vetme)

Shmang pyetjet e mbingarkuara ti tipit; *Pasi more X dhe shkove tek Y, çfarë i ndodhi Z ..?*

Shmang pyetjen **PSE?**, sidomos me fëmijët e vegjël.

Mos bëj pyetje sugjestionuese psh; *Ti e pe kur e mori çantën apo jo..*

Mos projekto ndjesitë apo mendimet e tua që mund të lindin gjatë procesit të intervistimit tek femija.

Shmang shprehjen e dyshimit mbi atë që tregon fëmija psh; *Je I siurtë që ai tha ashtu?*

Shmang pyetje që janë përgjithësuese, sepse ato shpesh mund të çojnë në përgjigje të tipit “ nuk e di” apo “ nuk e mbaj mend”. Mos pyet : *Të ka rrahur ndokush ndonjëherë?*

Përdori të gjitha kuptimet e mundshme për të krijuar një kuadër më të mirë mbi ngjarjen dhe për të ndihmuar fëmijën të kujtojë më mirë psh; çfarë ngjyre kishte makina? (trego shumë alternative duke përdorur letra më ngjyra të ndryshme apo lapsa me ngjyra të ndryshme)

Përdor metodën “ plotëso historinë”. Fillo historinë mbi informacionin që mund të jetë siguruar nga burime të tjera dhe më pas lejo fëmijën të vazhdojë.

6. Komunikimi jo verbal

Vëzhgimi është një mënyrë e mirë për të marrë informacion, sidomos me fëmijët e vegjël. Vëzhgo nëse fëmija ka kontakt me sy me intervistuesin apo dikë tjetër, apo nëse e shmang atë. Kjo ndihmon për të kuptuar gjëndjen emocionale të fëmijës; nëse është i qetë, aktiv, pasiv, agresiv, i tërhequr, i frikësuar, ankthioz, me mungesë përqendrimi etj. Vëzhgimet e ndryshimeve të papritura të sjelljes së fëmijës gjatë intervistës, si të qëndrimit të trupit, mënyrës së të shprehurit, apo ndryshime të dukshme emocionale, shërbejnë si tregues për të kuptuar se çfarë po përjeton fëmija dhe se si intervistuesi duhet të përshtasë vazhdimin e bisedës.

Përpiqu të vendosësh dhe të ruash kontaktin me sy me fëmijën gjatë intervistës. Tregohu i vëmëndshëm tek fëmija, por i lejoi atij hapësirën që ka nevojë.

Tregohu një dëgjues i mirë. Nëpërmjet komenteve, lëvizjeve të duarve dhe reagimeve të përshtatshme emocionale, ju i tregoni fëmijës se po e dëgjoni atë në mënyrë aktive, duke ia bërë rrëfimin më të lehtë. Në moment të caktuara të intervistës bëj shenja që po kupton çfarë po thuhet dhe komente mbështetëse psh; Po.. ehe.. kuptoj.. vertetë..? më vjen keq për këtë..

7. Kur fëmija hesht

Nëse fëmija nuk ndjehet I gatshëm t’ju përgjigjet pyetjeve apo të flasë, ju mund ta ftoni fëmijën që t’ju bëjë ai disa pyetje ju. Nëse fëmija nuk dëshiron të flasë për një çështje të caktuar që mund të jetë e rëndësishme për ju, por ka dëshirë të flasë për diçka tjetër, lëroni çështjen e rëndësishme për më vonë. Thuaji fëmijës së intervistuar se ju e kuptoni vështirësinë e tij/saj për të folur për çështjen dhe se ndoshta mund të flisni për këtë gjë më vonë. Pas pak minutash, ti mund ta pyesësh fëmijën;

Si thua, flasim për X tani..? Mendon se je gati të flasim për këtë gjë? Ke dëshirë ta fillojmë me ndonjë vizatim? Nëse ke dëshirë mund të vizatosh dhe të ngjyrosësh dhe më pas une do të të pyes për atë që ke vizatuar.

Nëse fëmija refuzon të flisni bashkë, veprimet në vijim mund t’ju vinë në ndihmë;

Përdor kontakt fizik të lehtë për treguar shqetësimin tënd, psh vendosi dorën mbi shpatulla, preki lehtë kokën apo jepi një shami nëse fillon të përlozet.

IV. Elemente të veçantë të zhvillimit të fëmijëve adoleshent që ndikojnë mbi dinamikën e intervistës.

Diferencat në aftësitë kognitive midis një intervistuesi të rritur dhe një adoleshenti i dëmtuar, dëshmitarë apo të dyshuar për një vepër penale, përbëjnë një sfidë të vazhdueshme në procesin e intervistimit. Le të shohim disa nga këto diferenca.

➤ Adoleshentët i procesojnë pyetjet ndryshe nga të rriturit.

Aftësia e fëmijëve dhe adoleshentëve për të kuptuar atë çfarë thonë të tjerët dhe për t'u shprehur zhvillohet me rritjen e tyre në moshë. Në përgjithësi adoleshentët fillojnë të mendojnë më shumë si të rritur se si fëmijë, për shkak se ata janë në një proces zhvillimi të aftësive për të komunikuar. Gjithsesi, ky është një zhvillim gradual dhe arrin pjekurinë e plotë vetëm në adoleshencën e vonë. Është e rëndësishme gjithashtu të mbahet parasysh se shumë adoleshentë të cilët përfshihen në sistemin e drejtësisë kanë probleme të të nxënimit dhe të vëmendjes. Për këtë arsye, intervistuesi duhet të konsiderojë aftësinë e adoleshentit për të kuptuar dhe përdorur gjuhën, nivelin e fjalorit, aftësinë për të menduar në mënyrë abstrakte si dhe elementë të tjerë të zhvillimit kognitiv.

➤ Adoleshentët përqendrohen më shumë te e tashmja dhe shfaqin vështirësi të mendojnë për të ardhmen.

Qasja e adoleshentëve ndaj kohës ndryshon nga ajo e të rriturve. Në përgjithësi ata priren të mos konsiderojnë shumë të ardhmen dhe i kushtojnë më shumë rëndësi pasojave afat-shkurtëra për kundrejt atyre afat-gjata (rreziqet dhe përfitimet) të vendimeve që mund të marrin. Ata janë më shumë të prirur të flasin mbi atë se çfarë do të ndodhë atë ditë, se sa të flasin për dicka që mund të ndodhë në të ardhmen. Psh gjatë një interviste adoleshenti është më i interesuar të dijë nëse ai do të lirohet po atë ditë, se sa ndonjë pyetje që mund të bëjnë intervistuesi mbi faktin nëse do shkojë përsëri në shkollë apo do të fillojnë punë. Për këtë arsye, intervistuesi duhet të krijojë lidhje midis informacionit që ai ka nëvojë të dijë dhe interes të adoleshentit, në mënyrë që ky i fundit të kuptojë më mirë bisedën. Në disa momente, intervistuesi duhet të adresojë shqetësimet momentale të adoleshentit dhe ta rivendosi bisedën përsëri në rrjedhën e saj.

➤ Adoleshentët mund të jenë fanatik të drejtësisë (paanësisë).

Me rritjen e aftësive të tyre kognitive, adoleshentët shpesh herë i brendësojnë principet e asaj çfarë është e drejtë me një prirje hakmarrjeje. Ata ngulmojnë në mënyrë idealiste mbi mënyrën se si duhet të jenë gjërat dhe nuk janë tolerat ndaj gjërave arbitrare dhe të padrejta. Për më tepër si rrjedhojë e zhvillimit të tyre të nevojës për autonomi dhe rezistencës ndaj figurave autoritare, ata kanë prirjen të sfidojnë normat sociale në emër të asaj që ata e quajnë drejtësi. Në këtë kuadër, një gabim që ndodhë rutinisht nga ana e intervistuesve është se duke u ndjerë të justifikuar për kohën e kufizuar që kanë në dispozicion për të kryer intervistën, prezumojnë se adoleshenti duhet t'a mirëkuptojë dhe të bashkëpunojë duke ndjekur ritmin e tyre. Por ka shumë të ngjarë që adoleshentët të ndjehen të prekur nga kufizimet e vendosura nga intervistuesi dhe të ndjehen të mashtruar. Apo ata mund të ngecin duke korigjuar atë që ata bësojnë se është kuptuar gabim duke ulur kështu ritmin e intervistës. Kjo është një nga vështirësitë që intervistuesi duhet të ketë parasysh dhe të përpiqet t'i kalojë këto ngecje duke ruajtur rrjedhën e intervistës.

➤ Egocentrizmi

Adoleshentët kanë prirjen të jetë egocentrik. Ky përqendrim i madh tek vetja i bën ata të besojnë gabimisht se të tjerët i gjykojnë në mënyrë të vazhdueshme. Ata dyshojnë se të rriturit mund të kuptojnë eksperiencat e tyre. Për këtë arsye është shumë e rëndësishme që intervistuesi të fitojë besimin e adoleshentit duke mos bërë pyetje me tendencë gjykuese dhe duke mos mbajtur qëndrime moraliste mbi atë që rrëfen adoleshenti gjatë intervistës.

➤ *Zhvillimi I identitetit*

Adoleshentët janë në përpjekje për të krijuar një identitet të qëndrueshëm dhe për rrjedhojë shpesh herë I shohin bashkëmoshatarët e tyre si modele për t'u ndjekur dhe grupin e moshatarëve si dicka të cilën ata kanë nevojë t'I përkasin. Në këtë kuadër, edhe pyetjet më të pafajshme nga ana e intervistuesit mbi shokët e të intervistuarit do të perceptoheshin si kritika nga ky I fundit. Për rrjedhojë ata janë shumë besnik ndaj familjarëve dhe shokëve dhe mund të nxehen nëse intervistuesi nënkupton dicka negative mbi këta të fundit edhe pse ata mund të kenë abuzuar me ta apo ti kenë neglizhuar, apo të jenë të përfshirë në vepra kriminale.

Për këtë arsye intervistuesi duhet të zgjedh me kujdes kur strukturon pyetjet dhe të përdorë një ton zëri të qetë, duke i lënë të intervistuarit të kuptojë se ai nuk po e gjykon, por është realisht i interesuar mbi atë çfarë ka ky i fundit për të thënë.

➤ *Marrëdhënia me figurat autoritare*

Është normale që një adoleshent të mos i besojë të rriturve dhe të ndjehet i frikësuar nga personat e panjohur. Adoleshentët kur pyeten nga persona të rritur mendojnë se nuk kanë asgjë të përbashkët me ta. Ata mendojnë se edhe pse të rriturit shfaqen miqësor janë gjykues ndaj tyre dhe kanë prirjen të mos jenë bashkëpunues si kur janë viktima, dëshmitarë apo të dyshuar për një vepër penale. Por në disa raste ata mund të shfaqen shumë të ndjeshëm ndaj autoritetit dhe të bëhen prirur për t'u sygjestionuar nga intervistuesi I rritur duke pohuar atë çfarë do ky I fundit.

Për këtë arsye vendosja e raportit hedh themelet për një intervistë të sukseshme. Vendosja e kontaktit me sy është një element që ndihmon për të treguar se intervistuesi është I interesuar për atë çfarë rrëfen adoleshenti. Por shpesh herë mund të perceptohet edhe si shenjë kërcënuese. Për këtë arsye intervistuesi nuk duhet të përdorë kontaktin më sy përgjatë gjithë kohës së intervistës.

Gjithashtu nuk është e këshillueshme që adoleshenti të pyetet nga dy intervistues njëherësh. Ai do të ndjehej i kërcënuar dhe do të vihej në pozita mbrojtëse duke mos u shfaqur bashkëpunues.

1. Cilesitë që vinë në ndihmë në intervistimin e një adoleshenti

Cilesitë kryesore që duhet të ketë intervistuesi gjatë punës me adoleshentë janë:

- Të kuptojë stadin e zhvillimit që përkon me moshën e adoleshencës;
- Të vendosë marrëdhënie besimi pa u shfaqur diktues;
- Të jete I hapur për t'u lidhur me eksperiencat e të intervistuarit;
- Të mos jetë gjykues;
- Të ofrojë mbështetje emocionale dhe psikologjike;
- Të di të vendosë kufijtë e duhur gjatë intervistës;
- Të pranojë luhajtjet e emocioneve në adoleshencë;
- Të kuptojë pasojat e stresit dhe kujtimeve traumatike të një adoleshenti;
- Të identifikojë problemet e të intervistuarit dhe të bëjë referimin e duhur të rastit;
- Të ndihmojë të intervistuarin të rivendosë vete-vlerësimin.